



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë 17.07.2024 ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Caktimin e masës së sigurimit ndaj personave ndaj të cilëve zhvillohet hetimi: **Edmond Gashi** dhe **Emiljano Lela** të dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Shpërdorimi i detyrës*” dhe “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, e kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 248 dhe 259-25 të Kodit Penal; **Alketa Ymeri (Pere)**, **Brikena Qirjazi** dhe **Drilona Kishta** të dyshuara për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; **Halil Gashi** i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Fshehjes së të ardhurave*”, të parashikuar nga neni 180/1 i Kodit Penal, si dhe **Florian Marku** i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë*” dhe “*Ruajtja ose depozitimi i mallrave që janë kontrabandë*”, të parashikuara nga nenet 178 e 179 të Kodit Penal”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Ardit Mustafaj, bazuar në nenet 88, 228 e vijues, 244 dhe 245 të K.Pr.Penale, me vendimin **Nr. 84, datë 24.07.2024**, vendosi:

1.Caktimin ndaj shtetasit **Edmond Gashi** të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, si **i dyshuar**: Për kryerjen e veprave penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, dhe “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, e kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 248 dhe 259/2-25 të Kodit Penal.

- Urdhërohet personi ndaj të cilit zhvillohet hetimi **Edmond Gashi**, të mos largohet nga banesa e tij e ndodhur në adresën ****.

2.Caktimin ndaj shtetasit **Emiljano Lela** të masës së sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si **i dyshuar**: Për kryerjen e veprave penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, dhe “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, e kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 248 dhe 259/2-25 të Kodit Penal.

- Urdhërohet personi ndaj të cilit zhvillohet hetimi **Emiljano Lela**, të paraqitet të martën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 11:00 para oficerit së policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

3.Caktimin ndaj shtetases **Alketa Ymeri (Pere)**, të masës së sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si **e dyshuar**: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

- Urdhërohet personi ndaj të cilit zhvillohet hetimi **Alketa Ymeri (Pere)**, të paraqitet të martën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 11:00 para oficerit së policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

4.Caktimin ndaj shtetases **Brikena Qirjazi**, të masës së sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si **e dyshuar**: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

- Urdhërohet personi ndaj të cilit zhvillohet hetimi **Brikena Qirjazi**, të paraqitet të martën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 11:00 para oficerit së policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

5.Caktimin ndaj shtetases **Drilona Kishta**, të masës së sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si **e dyshuar**: Për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

- Urdhërohet personi ndaj të cilit zhvillohet hetimi **Drilona Kishta**, të paraqitet të martën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 11:00 para oficerit së policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

6.Caktimin ndaj shtetasit **Halil Gashi**, të masës së sigurimit “Detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, si **i dyshuar**: Për kryerjen e veprës penale “*Fshehjes së të ardhurave*”, të parashikuar nga neni 180/1 të Kodit Penal.

- Urdhërohet personi ndaj të cilit zhvillohet hetimi **Halil Gashi**, të paraqitet të martën e parë dhe të tretë të çdo muaji, ora 11:00 para oficerit së policisë gjyqësore, pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

7. Caktimin ndaj shtetasit **Florian Marku**, të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, si **i dyshuar**: Për kryerjen e veprave penale “*Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë*” dhe “*Ruajtja ose depozitimi i mallrave që janë kontrabandë*”, të parashikuara nga nenet 178 e 179 i Kodit Penal.

- Urdhërohet personi ndaj të cilit zhvillohet hetimi **Florian Marku**, të mos largohet nga banesa e tij e ndodhur në adresën ****.

8. Për ekzekutimin e këtij vendimi, ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe policia gjyqësore.

9. Kundër këtij vendimi bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 25.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar